


Shtojca nr. 1 Udhëzues për regjistrimin on-line nga kandidatët fitues

1. Për të kryer regjistrimin online duhet të shkoni tek linku: <http://matura.akp.gov.al>;
2. Te faqja e hapur do të keni pamjen e mëposhtme:



The screenshot shows the homepage of the Matura Shtetërore website. At the top left is the logo of the Agency for National Examinations (AKP) with the text "MATURA SHETËRORE Agjensia Kombëtare e Provimeve". At the top right is the logo of the Ministry of Education and Science (MASH) with the text "MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS". Below the logos is a navigation menu with the following items: > KRYESORE, MATURA, UDHËZIME DHE FORMULARË, PROGRAME ORIENTUESE, TESTE PËRGATITORE, and VITET MË PARË. The main heading is "FAQJA KRYESORE PËR MATURËN SHETËRORE". On the left side, there are two boxes: one with the text "Kontrolloni notat, shikoni ecurine e aplikimit tuaj." and a button "Identifikohuni"; the other with the text "Materiale të dobishme" and a link "→ Tabela e pikeve te fituesit te fundit per vitet 2007-2011". In the center, there is a paragraph: "Mund të përgjithshni materiale të përgjithshme nga menutë, apo të dhënat tuaja specifike nëse hyni në sistem duke vendosur të dhënat tuaja." Below this is another paragraph: "Nese jeni fitues tek nje nga programet e studimit duhet te kryeni regjistrimin. Per tu regjistruar tek programi i studimit ku jeni fitues klikoni tek butoni i meposhtem. Per tu regjistruar Online eshte e domosdoshme te hapni nje adrese e-mail." and a button "Regjistrohu ne fakultet".

3. Këtu duhet të klikoni te butoni : **“Regjistrohu në fakultet”** dhe do t’ju shfaqet pamja e mëposhtme:



The screenshot shows a registration form with the following fields and a button:

- ID e Maturantit
- Emri
- Atësia
- Mbiemri
- Karte Identiteti - Shembull
- Email i Maturantit
- Identifikohu

4. Te fushat e shfaqura duhet të plotësohen me kujdes të dhënat e kërkuara. Në fushën **“Karta e Identitetit”** duhet të vendoset **numri personal** (kliko mbi fjalën shembull dhe do të shfaqet një

kartë identiteti ilustruese). Numri personal , i kornizuar si më poshtë, gjendet në pjesën e poshtme, djathtas saj).



MATURA SHITETËRORE
Agjensia Kombëtare e Provimeve



mash
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

ID e Maturantit	<input type="text"/>
Emri	<input type="text"/>
Atësia	<input type="text"/>
Mbiemri	<input type="text"/>
Karte Identiteti - Shembull	
Email i Maturantit	<input type="text"/>
<input type="button" value="Identifikohu"/>	



5. Duhet bërë kujdes që të plotësohen të gjithat fushat dhe informacioni në to të jetë i saktë. Pas plotësimit klikoni te butoni: **“Identifikohu”**. Pasi të keni klikuar te ky buton, tek adresa e-mail-it e vendosur në fushën përkatëse do t’ju dërgohet një mesazh i cili përmban informacion për përdoruesin (Username) dhe fjalëkalimin (Password) tuaj, që mund ta përdorni për të rihyrë në sistem. Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi janë të dhëna konfidenciale dhe nuk mund ti jepen asnjë personi tjetër.
6. Nëse të dhënat tuaja nuk janë të sakta do të shfaqet mesazhi i mëposhtëm:

Te dhenat qe futet jane te pasakta. Saktesoni te dhenat ose paraqituni per regjistrim prane sekretarise se fakultetit perkates.

Identifikohu


Kjo do të thotë se për të bërë regjistrimin e fazës së parë ju duhet të paraqiteni detyrimisht pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit në Universitetin ku jeni shpallur fitues me dokumentin tuaj personal të identifikimit.

7. Nëse të dhënat tuaja janë të sakta do të vazhdoni procedurat e regjistrimit on-line sipas hapave të mëposhtme. Dritarja e mëposhtme shfaqet në ekran.


	MATURA SHETËRORE Agjensia Kombëtare e Provimeve	
Emri Ermirela	Vendlindja DURRËS	
Atësia Hasan	Shkolla e Mesme (526) BESNIK HIDRI, DURRËS	
Mbiemri Kota	Profili GJIMNAZI 2012	
Gjinia Femër		
Datelindja 27/06/1993		
Preferenca ne te cilen jeni shpallur fitues:		
Universiteti:	UNIVERSITETI I TIRANËS	
Fakulteti:	FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA	
Programi i studimit:	Gjuhë Gjermane	
Preferenca:	8	
Piket:	8700	
	Regjistrohu	Dil nga Faqja

Informacioni in mësipërm do të jenë të dhënat tuaja personale, të cilat plotësohen automatikisht nga sistemi pas konsultimit me bazën e të dhënave.

8. Për t'u regjistruar në fakultet, në fazën e parë, duhet të klikoni butonin: "**Regjistrohu**". Pasi klikoni te ky buton në adresën tuaj të email-it do t'ju dërgohet një mesazh konfirmues, i cili ju njofton se jeni regjistruar tek programi i studimit në të cilin jeni shpallur fitues. Më pas do t'ju shfaqet pamja e mëposhtme:



MATURA SHTETËRORE
Agjensia Kombëtare e Provimeve



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Regjistrimi u krye me sukses

Do të vazhdoni konkurimin për preferencat më të larta, apo konfirmoni regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar?

Vazhdoj konkurimin për një preferencë më të lartë
 Konfirmoj regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar

[Ruaj](#) [Dil nga faqja](#)

Preferenca	Program Studimi	Piket
1	Gjuhë Spanjolle	1,500.00
2	Gjuhë Ruse	2,500.00
3	Menaxhim Hotel Restorant	3,500.00
4	Financë – Kontabilitet	4,500.00
5	Gjuhë Angleze	5,500.00
6	Administrim - Biznes	6,500.00
7	Inxhinieri Agrare - Agromekanizim	7,500.00
8	Gjuhë Gjermane	8,700.00
9	Gjuhë Frënge	9,500.00
10	Shkencat e Lëvizjes	8,800.00

9. Nëse jeni shpallur fitues të një preferencë e ndryshme nga preferenca e parë dhe dëshironi të regjistroheni në mënyrë përfundimtare aty, pra të mos vazhdoni konkurimin për një preferencë më të lartë, duhet të zgjidhni (klikoni) opsionin: **“Konfirmoj regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar”** dhe më pas të klikoni tek butoni: **“Ruaj”**.
10. Nëse doni të vazhdoni konkurimin për preferencat më të larta zgjidhni opsionin: **“Vazhdoj konkurimin për një preferencë më të lartë”** dhe klikoni butonin: **“Ruaj”**
Pasi të klikoni te butoni **“Ruaj”** do t’ju shfaqet mesazhi **“Veprimi u krye me sukses”** dhe pas kësaj mund të dilni nga faqja dhe të mbyllni browserin e internetit.
11. Sjellim në vëmendje, veprimi i regjistrimit on-line lejohet të kryhet vetëm njëherë.
12. Studenti dorëzon, gjatë javës së parë të frekuentimit të studimeve universitare në programin që studenti ka fituar, pranë sekretarisë mësimore, dokumentet plotësuese të përcaktuara në këtë udhëzim.